



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 618/15 Prot

Durrës, më: 05.03.2026

V E N D I M

Nr. 36, datë 05.03.2026

PËR

**"MIRATIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE KËRKIMORE SHKENCORE TË
CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË" NË SHKENCA
EKONOMIKE, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, PRANË FAKULTETIT TË
BIZNESIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Udhëzimit Nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e Gradës Shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"; të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të shkresës së Fakultetit Biznesit administruar me Nr. 340 prot., datë 04.02.2026 "Përcillen për miratim lista e projekteve kërkimore shkencore për Ciklin e tretë të studimeve "Doktoratë" në "Shkenca Ekonomike" për vitin akademik 2026-2027, Fakulteti i Biznesit", si dhe në relacionin me Nr. 340/2 prot., datë 03.03.2026 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 05.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së projekteve kërkimore shkencore të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Shkenca Ekonomike", pranë Fakultetit të Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027, si më poshtë:

- Transformimi i biznesit në epokën e digjitalizimit dhe ndërkombëtarizimit: Një perspektivë mbi sipërmarrjen dhe konkurrueshmërinë në rajonin e Ballkanit, me drejtues shkencorë: Prof. Dr. Bajram Korsita.
- Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit në Shqipëri në organizatat e biznesit në Shqipëri: Ndërkombëtarizimi, transformimi digjital dhe zhvillimi i qëndrueshëm, me drejtues shkencorë: Prof. Dr. Bajram Korsita.
- Formimi ndërdisiplinor si faktor kyç në menaxhimin efektiv të projekteve: Një analizë e kompetencave, bashkëpunimit dhe rezultateve organizative, me drejtues shkencorë: Prof. As.Dr. Olta Nexhipi; Prof. As. Dr. Ulpian Hoti.
- Strategjitë e trajnim zhvillimit dhe ndikimi i tyre në performancën e

punonjësve në Shqipëri me drejtues shkencorë: Prof. As. Dr. Sanie Doda.

- Administrimi/Menaxhimi entiteteve private e publike në epokën digjitale: Një perspektivë mbi gadishmërinë e ekonomisë shqiptare për t'u përqasur në krijimin e vlerës ekonomike globale, me drejtues shkencorë Prof. Dr. Manuela Mece; Prof. Dr. Ermira Qosja.
- Transformimi digjital dhe inteligjenca artificiale në marketingun e turizmit në Shqipëri, me drejtues shkencorë: Prof. As. Dr. Blerim Kola; Prof. As. Dr. Vaeld Zhezha.
- Ndikimi i komunikimit miks në rritjen e tregut të sipërmarrjeve në Shqipëri, me drejtues shkencorë: Prof. As. Dr. Elton Noti; Prof. As. Dr. Ervin Myftaraj; Prof. As. Dr. Edlira Llazo; Prof. As. Dr. Violeta Neza.
- Algoritmet si kuratorë të komunikimit marketing, me drejtues shkencor: Prof. Dr. Azeta Tartaraj.
- Bankat e gjelbra si shtyllë e ekonomisë së qëndrueshme, roli i tyre në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, me drejtues shkencor: Prof. As. Dr. Arjeta Hallunovi.
- Roli i cilësisë së raportimit financiar dhe efektiviteti i politikave fiskale në promovimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, me drejtues shkencorë: Prof. As. Dr. Jonada Mamo.
- Rëndësia e digjitalizimit në menaxhimin e destinacioneve turistike, me drejtues shkencorë: Prof. As. Dr. Mirela Tase; Prof. As. Dr. Nevila Çinaj.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:

- Administratori
- Zv. Rektorët
- Dekani i Fakultetit të Biznesit
- Drejtorja e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

